



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “Agro Invest 1 shpk” të datës 05.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Agro Invest 1 shpk” të datës 05.07.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik “Agro Invest 1 shpk” (tutje “parashtruesi”) me datë 05.07.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës” me nr. të prokurimit 616-25-1830-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

P.1.- “ Ne dosje te tenderit te Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare 8.1 & 8.2, Kapaciteti ekonomik dhe financiar, jane kerkuar kontrata dhe referenca si ne vijim: Kerkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlere minimale prej 780,000.00€ Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit te Njoftimit për kontratë). Per te plotësuar kete kerkese ne si konzorcium Agro Invest- 1 Sh.p.k, Rexha Shpk & Multi Business Group Shpk, kemi paraqitur referenca qe deshmojne realizimin me sukses te kontratave ne vlere prej 1’905’560.86 euro te cilat po I listojme ne vazhdim; Kontrata te perfunduar nga ne si lider- “Agro Invest- 1” Sh.p.k: 1) Ndertimi strehimores- parkut te qenve me nr prokurimi 616-23-8963-5-2-1 ne vlere 187’115.00 euro 2) Ndertimi I sistemit te pompimit per furnizim me uje ne ndertesat kolektive dhe lagje nr prokurimi 616-22-5780-5-2-1 ne vlere 210’000.00’. Kontratat e anetarit tone te konzorciumit “Rexha” Shpk: 1) Rregullimi I varrezave te deshmores ne Viti te Marecit- Prishtine, ne vlere 537’892.00 euro. 2) Ndertimi I parkut rekreativo- sportive ne Dardani dhe renovimi I hapësirës, ne vlere 473’000.00 euro. 3) Ndertimi I parkut rekreativo- sportive ne kryeqytet, ne vlere 336’436.16 euro. 4) Implementimi I planit te mobilitetit- sanimi rikonstruimi I rrugëve trotuareve me gure natyral graniti dhe pllaka kubza betoni- lot III, ne vlere 490’000.00 euro. Kontratat e anetarit tjeter te konzorciumit - “Multi Business Group” Shpk: 1) Rregullimi I trotuareve dhe ndriçimi publik ne fshatin Petrove- faza Lv 617-22-3685-5-2-1, ne vlere 24’777.90 euro. 2) Rregullim i ujësjes, kanalizimit dhe infrastruktures tjeter ne fshatin Gllloboqice 621-22-1859-5-2-1, ne vlere 18’454.80 euro. 3) Zgjerimi I rruges Regjionale R 107 hyrja ne qytetin e Prizrenit MI-18-136-511- lot 1 ne vlere 25’000.80 euro. Te gjitha keto kontrata te realizuara nga Grupi yne I konzorciumit jane me kod te njejte- 45000000-7 te klasifikuara si Pune ndertimi ne Klasifikimin e Fjalorit të Përgjithshëm të Prokurimit (FPP), , te cilat korrespondojne plotësisht me natyrën e ketij projekti: Ndërtimi i rrethojave të varrezave të Komunës së Prishtinës”.

P.2.- “Sa i perket pretendimit tuaj se marrëveshjet tona të dorëzuara për stafin profesional dhe teknik nuk përmbajnë elementet e nevojshme të një parakontrate pune, si dhe se mungon një aneks shtesë në përputhje me Ligjin nr. 03/L-212 për Marrëdhëniet e Punës, ju argumentojme se një pretendim i tillë është i pabazuar dhe në kundërshtim të plotë me ligjin dhe praktikën e drejtë administrative. Konform kesaj kerkese ne kemi ofruar Listen e stafit profesional dhe atij teknik se bashku me Marrëveshjet te cilat përmbajnë të gjitha elementet thelbësore të përcaktuara me ligj për të cilësuar një marrëdhënie të vlefshme pune duke përfshirë: •Emrin e projektit per te cilin behet bashkepunimi; •Datën e lidhjes së marrëveshjes; •Të dhënat e plota të stafit (emër, mbiemër, pozicioni, detyra); • Perpilimi ne dy kopje dhe validiteti I marreveshjes per asistim deri ne perfundimin e plote te projektit nga kompania jone; •Nenshkrimi dhe vula e kompanise tone dhe stafit qe do te angazhohet ne kete tender. Pretendimi juaj mbi mungesën e një “aneksi” nuk mbështetet në asnjë dispozitë të Ligjit nr. 03/L-212. Ky ligj nuk parashikon askund ndonjë obligim ligjor për përfshirjen e një aneksi shtesë për vlefshmërinë e një parakontrate pune per bashkëpunim dhe nuk eshte kerkuar as ne dosje te ketij tenderi”.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsytet si në vijim:

ARSYETIM

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Ju si GOE-ik nuk i keni plotësuar kriteret e përcaktuara në Njoftimin për kontratë dhe Dosje të tenderit në Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale Neni 9.1 & 9.2, për piken e kërkesës nr.1. **Kërkesa: 1. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të ngjashme me vlerë minimale prej 780,000.00 € Euro, në 3 (tri) vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për kontratë). Dëshmia e kërkuar dokumentare: 1. Një liste të kontratave të realizuara duke përdorur Aneksin 6 në DT-së, ku duhet saktësuar titullin e kontratës, shumën, datën e fillimit, datën e**

përfundimit të kontratës, përfituesin, si dhe listës të bashkëngjitur referencat ose pranimet teknike për kryerjen e punëve në lëmin e kërkuar apo të ngjashme, për 3 (tre) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e shërbimeve (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën). Ju si GOE-ik: për këtë pikë të kërkesës me ofertën e tuaj keni prezantuar Kontrata dhe referenca me vlerë vetëm 187,000.00 euro të cilat i përgjigjen kërkesës se AK-së për punë të ngjashme (Kontrata dhe Referencat duhet të korrespondojnë me njëra tjetrën), ndërsa kontratat dhe referencat tjera të dorëzuara nuk kanë të bëjnë me natyrën e punës dhe as me ngjashmërinë e punëve. Dhe Sipas UDHËZUES NR. 002/2024, PËR PLOTËSIM NDRYSHIMIN E UDHËZUESIT NR. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK / Lista e kontratave të realizuara e dorëzuar nuk përmbush kërkesat minimale të vlerës së përcaktuar / Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm/ Neni 69 i LPP-së.

Ju si GOE-ik për të gjithë stafin profesional dhe teknik keni paraqitur marrëveshje bashkëpunimi, ku në nenin 1 të kësaj marrëveshje shkruhet: “Kjo marrëveshje ndërmjet palëve me datë 11/04/2025 për bashkëpunim behet me qëllim të asistimit për realizim të projektit”. Marrëveshjet e dorëzuara për stafin profesional dhe teknik nuk përmbajnë të gjitha pikat të cilat duhet të ketë një kontratë apo marrëveshje për punë. GOE-ik edhe pse ka dorëzuar këtë marrëveshje nuk e ka të cekur askund që në rast të shpërblimit me kontratë do të bëjnë një aneks marrëveshjeje ku në bazë të LIGJI NR. 03/L-212 I PUNËS do të jenë të përcaktuara: Vlefshmëria e kontratës, orari dhe vendi i punës, kompensimi i pagës, pushimi vjetor dhe mjekësor, ndërprerja e kontratës etj. Andaj dhe për arsyeje të cekura më lartë jeni eliminuar nga ky Aktivitet i Prokurimit.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që parashtruesi lista e kontratave të prezantuara që janë realizuar në tre vitet e fundit para njoftimit për kontratë dhe që janë kontrata të ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit, nuk arrijnë vlerën e kërkuar sipas DT. Komisioni ka gjetur se janë prezantuar edhe kontrata të tjera mirëpo të cilat nuk janë të natyrës së ngjashme. Ndërsa kundërargumenti i prezantuar nga AK se kontrata janë të natyrës së punës ndërtimore FPP 45000000-7, ky argument nuk qëndron pasi që jo të gjitha kontratat e punës janë të ngjashme mes vete. Ekzistojnë punë për ndërtim të lartë, për ndërtim të ulët, për pastrimin e lumenjëve, për mirëmbajtjen e rrugëve, etj. Në rastin konkret janë kërkuar kontrata të ngjashme për ndërtimin e rrethojave. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar. Ndërsa sa i përket pretendimit tjetër lidhur me marrëveshjen për angazhim dhe argumenti që nuk është kërkuar aneks, përbën tentim për keqinterpretim të arsyes për eliminim pasi që nuk është kërkuar dorëzimi i aneksit mirëpo arsyeja eliminuese ka të bëjë me faktin që marrëveshja që ju keni prezantuar nuk i përmban as

elementet esenciale të një marrëveshje për angazhimin e një punonjësi dhe ju nuk i keni lënë as mundësinë vetes që të plotësoni dokumentin e tillë përmes një aneksi. Prandaj pretendimi ankimor është i pabazuar.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 07.07.2025



Visar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.